Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Ibadete Guri	**22.09.2026**	**01.10.2026**	**2026/0717**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 18.09.2026, OE " Premium Bakery " SH.P.K."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2026/0717, kundër njoftimit mbi vendim te AK-s për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "Grup i Operatorëve Ekonomik MEKA SH.P.K.; HC STORE SH.P.K.; Bajram R. Imeri B.I, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me artikuj ushqimor" me nr. të prokurimit: "201/26300-26-4817-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Agjencia Qendrore e Prokurimit . Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur , lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës për Lot 6 - 4,350,000.00€. Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

- Neni 1 i LPP-së – Qëllimi;
- Neni 6 i LPP-së – Ekonomiciteti dhe efikasiteti;
- Neni 7 i LPP-së – Barazia në trajtim / jo-diskriminimi;
- Neni 59 i LPP-së – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahsaimi i tenderëve
- Neni 60 i LPP-së – Kriteret për dhënien e kontratës;
- Neni 61 i LPP-së – Tenderët jo-normalisht të ulët;

- Neni 68 i LPP-së – Kapaciteti ekonomik dhe financiar;

- Neni 69 i LPP-së – Kapaciteti teknik dhe profesional;

- Neni 41 I Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, ndryshuar dhe plotësuar me Rregullloren Nr. 002/2024- Tenderët jo-normalisht të ulët;

- Neni 25 I Rregullores- Kërkesat e përshtatshmërisë/kriteret e përzgjedhjes;

V. PRETENDIMET

PRETENDIMI ANKIMOR 1: Mos përcaktimi I anëtarit që do të kryej furnizimet e Lotit 6

Për Lotin 6, pika 9.1, Kërkesa 3 e DT-së kërkon që operatori të jetë *"i regjistruar në regjistrin e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë si prodhues dhe përpunues i Bukës – KËRKOHET VETËM per Lot 6"*.

Në grup, këtë regjistrim e ka vetëm **HOME BAKERY** (vendimi AUV Ref. AUV-01-075-2020, 11.02.2020). Lideri MEKA SH.P.K. merret me përpunimin e mishit, ndërsa as MEKA SH.P.K. as HC STORE SH.P.K. nuk janë të regjistruar si prodhues të bukës.

Sipas marrëveshjes së grupit, HOME BAKERY merr përsipër vetëm **10%** të kontratës. Pjesa tjetër prej **90%** u takon MEKA SH.P.K. (51%) dhe HC STORE SH.P.K. (39%):

5. **Ne të gjithë anëtarët e grupit** konfirmojmë pjesëmarrjen tonë në grup dhe deklarojmë se % *(përqindjen)* e pjesëmarrjes ne realizimin e kontratës është:

   a) *MEKA SHPK – Lider - 51%*
   b) *HC STORE – anetar - 39%*
   c) *HOME BAKERY – anetar - 10%*

6. **Ne të gjithë anëtarët e grupit** konfirmojmë përgjegjësitë e secilit anëtar:

   a) *MEKA SHPK (Lider – 51%) – Koordinimi dhe menaxhimi i kontratës, përfaqësimi i grupit para Autoritetit Kontraktues, koordinimi i furnizimeve dhe realizimi i 51% të furnizimit.*

   b)*HC STORE SHPK (39%) –. Furnizimi dhe dorëzimi i furnizimeve sipas specifikimeve teknike dhe realizimi i 39% të kontratës. HC STORE SHPK është i autorizuar të lëshojë dhe dorëzojë faturat në emër të grupit për furnizimet e realizuara nga grupi, ndërsa pagesat përkatëse të bëhen në xhirollogarinë bankare të HC STORE SHPK.*

   c)*HOME BAKERY (10%) – Furnizimi dhe dorëzimi i furnizimeve sipas specifikimeve teknike dhe realizimi i 10% të kontratës.*

Pamja 1 – Marrëveshja e grupit, pikat 5 dhe 6

Grupi ka ofertuar për Lotet 1, 5 dhe 6, por marrëveshja nuk tregon se kush çka furnizon në cilin lot. Vetëm Loti 6 është rreth 39% e vlerës së tri loteve (4,350,000 € nga 11,060,000 €). Pra, me 10%, HOME BAKERY nuk mund ta furnizojë Lotin 6. Shumica e bukës do të furnizohej nga anëtarë që nuk janë të regjistruar si prodhues të bukës.

Përgjigjja e AK-së dhe pse është e gabuar

AK thotë se *"lejohet me LPP plotësimi i kërkesave nga një Grup i Operatoreve Ekonomik duke u mbështetur ne kapacitetet e anëtareve te tij – referoju nenit 71 në veçanti paragrafit 4 të LPP-së"*.

Ne nuk e kontestojmë që kërkesa vlen për grupin si tërësi. Por Rregullorja e thotë qartë se **autorizimin duhet ta ketë anëtari që e kryen furnizimin**:

> *"Në rast grupi operatorësh ekonomik, kjo kërkesë vlenë ndaj grupit si tërsi, mirëpo i pajisur me autorizim apo licencë në kuptim të këtij neni duhet të jetë anëtari i grupit i cili kryen furnizimin, shërbimin apo punën." (neni 25.15 i Rregullores)*

Njësoj edhe neni 26.8 i Rregullores thotë se dëshmia *"mjafton të sillet nga anëtari i grupit i cili do të kryej furnizimin"*. Edhe neni 69.8 i LPP-së kërkon që grupi të dëshmojë se *"do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme për ekzekutimin e kontratës"*.

Në rastin tonë, anëtari me regjistrim në AUV kryen vetëm 10% të kontratës. AK nuk e ka shikuar fare marrëveshjen e grupit. Prandaj oferta e GOE-së nuk e plotëson Kërkesën 3 dhe nuk është e përgjegjshme (neni 59.4 i LPP-së, neni 40.6 i Rregullores).

KËRKESË: Kërkojmë nga OSHP që ky pretendim të aprovohet si i bazuar, pasi marrëveshja e GOE-së nuk përcakton që furnizimet e Lotit 6 në përputhje me kërkesën e AUV-së, duke qenë se vetëm HOME BAKERY e posedon dëshminë përkatëse dhe ka pjesëmarrëje vetëm 10% në realizimin e kontratës.


PRETENDIMI ANKIMOR 2: Mospërmbushja e kërkesës për qasje të pakushtëzuar në kredi

Pika 8.1, Kërkesa 2 e DT-së kërkon *"mjete të gatshme në bankë ose mbështetje bankare qasje te pakushtezuar në kredi"*. Për Lotin 6 minimumi është 655,000.00 €, dhe 51% duhet ta plotësojë lideri.

Lideri MEKA SH.P.K. ka dorëzuar letrën e BKT-së (Protokol nr. 753/1519, 12.08.2026) për Lotet 1, 5 dhe 6, deri në 1,665,000 €. Letra përdor fjalët "pa kushtëzim", por në të njëjtën fjali vendos dy kushte:

(i) *"Ne rast se Shoqeria e fiton të drejtën e zhvillimit të projektit"*; dhe

(ii) *"gjithmonë konform kritereve të kreditimit të vendosura nga Banka Qendrore, procedurave dhe regulloreve të brendshme të Bankes Kombëtare Tregtare SH.A"*.



BANKA KOMBËTARE TREGTARE

BKT KOSOVË
Dega Skënderaj
Protokol. Nr. 753/1519
Skenderaj: 12 Gusht 2026

Për: **MINISTRIA E FINANCAVE**
Prishtinë, Kosovë

Nga: **BANKA KOMBËTARE TREGTARE KOSOVË SHA**

Adresa: Rr.Ukshin Hoti Pejton, 10 000 Prishtinë, Kosovë

Subjekti: Referenca: **"Furnizim me Artikuj Ushqimor Loti 1, Loti 5, Loti 6 Nr.Prokurimit " 201/26300-26-4817-1-1-1"**

Theksojmë se Kompania **MEKA SHPK**, me numër identifikues **811219197**, me pronar **BURIM PIRAJ**. Kemi diskutuar qëllimin e Kompanise ne fjalë për mbeshtetje finanaciare sipas References: **"Furnizim me Artikuj Ushqimor Loti 1, Loti 5, Loti 6 Nr.Prokurimit " 201/26300-26-4817-1-1-1 "**

Ne këtë kuadër ne rast se Shoqeria e fiton te drejtën e zhvillimit të projektit, **Banka Kombëtare Tregtare SH.A** e mbeshtet pa kushtezim shoqerine **MEKA SHPK**, për financimit e këtij projekti deri në **1,665,000 EUR** (Një Milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pesëmijë Euro), gjithmonë konform kritereve të kreditimit të vendosura nga Banka Qendrore, procedurave dhe rregulloreve të brendshme te Bankes Kombëtare Tregtare SH.A .

Deshirojme t'ju informojmë se Banka merr ne konsideratë me interes të veçant çdo kerkese financiare qe lidhet ne qellimin e permendur me lartë.

Konfirmojmë se jemi bankë e regjistruar në Bankën Qendrore të Kosovës e cila nuk është në listën e zezë të Grupit Punues për Veprime Financiare ("FATF").

Sinqerisht,

Pamja 2 – Letra e BKT-së për MEKA SH.P.K.

Kushti i dytë do të thotë se banka do ta shqyrtojë kërkesën për kredi sipas rregullave të veta dhe mund ta refuzojë. Kjo nuk është kredi e pakushtëzuar, siç kërkon DT-ja.

Përgjigjja e AK-së dhe pse është e gabuar

AK thotë se lideri *"ka dorëzuar dokumentin nga banka që e mbështet për këtë projekt pa kushtëzime"*. AK e ka marrë vetëm fjalën "pa kushtëzim" dhe nuk i ka lexuar kushtet që janë shkruar menjëherë pas saj. Rëndësi ka përmbajtja e letrës, jo fjala që përdoret në të.

As gjendjet bankare në ofertë nuk e plotësojnë kërkesën. Gjendja prej 421,234.46 € (TEB, 22.07.2026) tregon një transfer të së njëjtës ditë në llogari rrjedhëse dhe nuk dëshmon se paratë ishin ende aty më 14.08.2026. Gjendja prej 68,776.15 € është e datës 25.06.2026, pra para publikimit të tenderit.

KËRKESË: Kërkojmë nga OSHP që ky pretendim të aprovohet si i bazuar, pasi letra e BKT-së, e kushtëzuar me kriteret e kreditimit dhe me procedurat e brendshme të bankës, nuk dëshmon qasje

të pakushtëzuar në kredi, siç kërkohet shprehimisht me pikën 8.1, Kërkesa 2 dhe pikën 8.2, Evidenca 2 të DT-së.

PRETENDIMI ANKIMOR 3: Mospërmbushja e kërkesës për furnizime të ngjashme nga lideri i grupit të Operatorëve Ekonomik

Pika 9.1, Kërkesa 1 e DT-së kërkon:

> *"Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses furnizim me produkte të ngjashme në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te këtij njoftimi për kontrate) minimum: [...] Lot 6: 6,500,000.00€. Në rast të grupit të OE-ve, së paku 51% e furnizimeve të përfunduara kërkohet për liderin e grupit."*

Kjo kërkesë duhet lexuar bashkë me produktet e Lotit 6. Sipas listës së çmimeve, Loti 6 përfshin:

- Bukë e bardhë, min. 500 g;
- Bukë e zezë, min. 500 g;
- Kifle kroasan / kifle, min. 100 g (me xhem, djathë ose çokollatë);
- Byrek me mish, djathë ose spinaq, 250 g;
- Bukë e bardhë e ambalazhuar me folie najloni, min. 100 g;
- Bukë integrale për sanduiç, min. 100 g.

Pra, AK nuk ka kërkuar furnizim me "çfarëdo produkti ushqimor", por **furnizim me produkte të ngjashme me këto**: bukë dhe brumëra. Kjo përputhet me nenin 69.2 të LPP-së, sipas të cilit aftësia dëshmohet *"sipas llojit, sasisë dhe qëllimit të produkteve"*, dhe me nenin 25.14 të Rregullores, sipas të cilit kriteret për çdo lot duhet të jenë *"drejtpërdrejtë relevante [...] në raport me objektin, lëndën dhe vlerën e lotit"*. Nëse furnizimi me mish do të llogaritej si "i ngjashëm" me bukën, e njëjta referencë do të vlente njëkohësisht për Lotin 1 (mish) dhe për Lotin 6 (bukë), dhe kriteri nuk do të kishte kuptim.

Meqë lideri duhet të dëshmojë së paku 51%, MEKA SH.P.K. duhet të ketë furnizuar **produkte të ngjashme me bukën në vlerë prej së paku 3,315,000.00 €**.

Çka ka dorëzuar lideri MEKA SH.P.K.

MEKA SH.P.K. ka dorëzuar listën e furnizimeve me vlerë totale prej 12,929,610.00 €. Por vlera totale nuk mjafton. Duhet parë **çka është furnizuar**. Sipas vetë referencave:

a) Referenca e PROEX SH.P.K. – 3,544,756.33 €. Në referencë shkruan se MEKA SH.P.K. *"ka furnizuar dhe vazhdon të furnizojë me produkte të mishit"*. Nuk përmendet bukë, kifle, kroasan, byrek, bukë e ambalazhuar apo bukë integrale.

Referencë

PROEX SHPK

NUI:810806862

NR.TVSH:330124652
Adresa:Prishtinë,Rr.Fehmi Lladrovci 32(hypermarket interex)

Republika e Kosovës

E leshuar me Daten : 24.07.2026

Kompania jonë "Proex "Sh.p.k.' në bazë të kërkesës së kompanisë "Meka Shpk" lëshon këtë referencë me qëllim të dëshmisë se kompania e lartpërmendur ka furnizuar dhe vazhdon të furnizojë me produkte të mishit kompaninë "Proex Sh.p.k..

Viti 2023 – 973,123.50 €
Viti 2024 – 1,018,656.46 €
Viti 2025 – 1,019,430.45 €
Viti 2026-01.01-30.06.2026- 536,545.92 €
Në total – 3,544,756.33 €

Duke marrë parasysh këtë, kompania jonë rekomandon Meka Sh.p.k. për të gjitha institucionet publike dhe private si kompani serioze në furnizim të produkteve të mishit dhe kryrjen e të gjitha marrëveshjeve me kohë dhe me profesionalizem .

Për te vërtetuar këtë reference mund të na kontaktoni si më poshtë:

Kontakti: Liridon Rashani Email:liridonrashani@interex-supermarket.com
Nenshkrimi Yuia

Pamja 3 – Referenca e PROEX SH.P.K.

b) Referenca e ELKOS SH.P.K. – 1,648,739.35 €. Edhe këtu shkruan qartë se MEKA SH.P.K. ka furnizuar *"me produkte të mishit"*. As kjo referencë nuk ka të bëjë me produktet e Lotit 6.

Referencë

ELKOS SHPK
Rr.Zahir pajaziti ,pn Pejë

Republika e Kosovës

E leshuar me Daten : 16.07.2026

Kompania jonë 'Elkos Sh.p.k.' në bazë të kërkesës së kompanisë 'Meka Shpk.' lëshon këtë referencë me qëllim të dëshmisë se kompania e lartpërmendur ka furnizuar dhe vazhdon të furnizojë me produkte të mishit kompaninë 'Elkos' Sh.p.k.

Viti 2023 – 444,877.48 €
Viti 2024 – 498,471.58 €
Viti 2025 – 494,353.28 €
Viti 2026-01.01-30.06.2026- 211,637.01 €
Në total – 1,648,739.35 €

Duke marrë parasysh këtë, kompania jonë rekomandon Meka Sh.p.k. për të gjitha institucionet publike dhe private si kompani serioze në furnizim të produkteve të mishit dhe kryrjen e të gjitha marrëveshjeve me kohë dhe me profesionalizem .


Për te vërtetuar këtë reference mund të na kontaktoni si më poshtë:

Kontakt: +383 49 779 312
Email:

Suad muriqi

Pamja 4 – Referenca e ELKOS SH.P.K.

c) Referenca e ELI-AB SH.P.K. – 321,866.20 €. Në referencë thuhet se MEKA SH.P.K. ka realizuar *"furnizime me produkte te mishit"*.



LETËR REFERENCE

ELI - AB SH.P.K. | Ferizaj
Nr. Unik: 811046641

Përfituesi
MEKA SH.P.K.
NUI: 811219197
Adresa: Rr. Tyrbes nr.27, plavë,Shtet Republika e Kosovës

Deklaratë
Vërtetojmë se kompania MEKA SH.P.K. ka realizuar furnizime me produkte te mishit për ELI - AB SH.P.K. gjatë periudhes 01.01.2023–31.12.2025. Bashkepunimi është zhvilluar në mënyrë profesionale dhe të gjitha detyrimet kontraktuale janë përmbushur me sukses.

Periudha	Vlera (€)
2023	104,250.60
2024	117,913.11
2025	99,662.55
TOTALI	321,866.20

Kjo letër referuese lëshohet me kërkesë të kompanisë MEKA SH.P.K. për përdorim të procedurat e prokurimit dhe për qëllime të tjera zyrtare.

Data e lëshimit: 27.07.2026

Faik Soja

Nr kontaktues 044 120 878


Email:eliabfr@gmail.com

Menaxher / Drejtar
(Vulë dhe Nënshkrim)

ELI-AB

Pamja 5 – Referenca e ELI-AB SH.P.K.

d) Referenca e VIVA FRESH – 5,832,748.68 €. Kjo është referenca më e madhe. Në të shkruan se MEKA SH.P.K. ka furnizuar *"Produkte te mishit dhe produkte te ndryshme ushqimore"*, por nuk thuhet cilat janë këto "produkte të ndryshme ushqimore". Nga kjo referencë nuk mund të dihet nëse është furnizuar bukë apo ndonjë produkt tjetër i Lotit 6.



REFERNCË

VIVA FRESH ME NR UNIK 810670390 në bazë të kërkesës së kompanisë''MEKA SHPK'' ME NR UNIK 811219197

Lëshon këtë Referencë,me qëllim të dhënimit ne kompania e larë përmendur ka furnizuar dhe vazhdon të furnizojë me Produkte te mishit dhe produkte te ndryshme ushqimore ''VIVA FRESH ''.

MEKA SHPK ka furnizuar ''VIVA FRESH'' **sipas vlerë dhe vlerës në poshtë:**

VITI 2023 1,578,804.576
VITI 2024 1,669,873.866
VITI 2025 1,738,737.026
VITI 2026 01.01 -30.06-2026 845,333.230

TOTAL: : **5,833,748.68€**

Dalie marrëpunonjës këtë kompania jonë rekomandon MEKA SHPK për të gjitha institucionet publike dhe private si kompani serioze në furnizim me Produkte te mishit dhe produkte te ndryshme ushqimore dhe kryejnë o të gjitha marrëveshtojeve më kohë dhe me profesionalizem.

Për të vërtetuar këtë referencë mund të na kontaktoni si më poshtë:

Personi përgjegjes:

Email:nvirtuoza.rustullia@vivafresh-dfs.com
Tel:049-998-036

Pamja 6 – Referenca e VIVA FRESH

e) Referencat e tjera kanë të njëjtin problem, edhe pse me vlera më të vogla:

- ALBINI SH.P.K.: "produkte ushqimore të konsumit të gjerë";
- VIVA FLY: "produkte të mishit dhe ushqimore të konsumit të gjerë";
- Arjeta Group SH.P.K.: "produkte të mishit dhe produkte të ndryshme ushqimore";
- NORA Market: "produkte ushqimore dhe mish".

Përfundimi për referencat

Referencat	Vlera (€)
Vetëm mish (PROEX, ELKOS, ELI-AB)	5,515,361.88
Pa specifikim të produkteve ("produkte ushqimore")	7,414,248.12
Furnizime me bukë ose brumëra të përmendura në referenca	0.00
Minimumi i kërkuar nga lideri për Lotin 6	3,315,000.00

Asnjë referencë e liderit nuk përmend bukë, kifle, kroasan, byrek, bukë të ambalazhuar apo bukë integrale. Dëshmitë bankare tregojnë vetëm qarkullim, pa numër fature dhe pa emër produkti, ndërsa faturat mungojnë. Për blerës privatë, pika 9.2, Evidenca 1 e DT-së dhe neni 25.16 i Rregullores kërkojnë dokument të nënshkruar nga blerësi *"dhe evidentimi i livrimit të tillë me dëshmi të pagesës nga banka"*. Neni 69.2.1 i LPP-së kërkon listë *"duke saktësuar produktet e furnizuara"*. Asnjëra nga këto nuk është plotësuar për produkte të ngjashme me Lotin 6.

Edhe anëtarët e tjerë nuk e plotësojnë këtë mungesë. HC STORE SH.P.K. ka listuar 39 kontrata, por ka bashkëngjitur vetëm 4 referenca me operatorë privatë, të lëshuara pas publikimit dhe në format të njëjtë. Për autoritetet publike ka shënuar vetëm numra faturash, pa raporte pranimi. HOME BAKERY, i vetmi prodhues i bukës, sipas listës së vet ka furnizuar kryesisht HC STORE

SH.P.K., që është anëtar i të njëjtit grup, dhe ka dhënë vetëm referencë, pa fatura dhe pa transaksione bankare.

Përgjigjja e AK-së dhe pse është e gabuar

AK thotë se *"nuk është kërkuar kontrata te përfunduara në tri vitet e kaluara por furnizime te përfunduara. Me këtë rast Grupi ka ofruar dëshmi dukshëm mbi vlerën e kërkuar dhe në veçanti lideri i grupit"*.

(i) AK nuk thotë asnjë fjalë për **produktet e ngjashme**, që është thelbi i pretendimit tonë. DT-ja nuk kërkon çfarëdo furnizimi, por furnizim me produkte të ngjashme me Lotin 6.

(ii) AK e ka shikuar vetëm vlerën totale. Duke e injoruar llojin e produkteve, AK e ka ndryshuar kriterin gjatë vlerësimit, gjë që e ndalon neni 40.2 i Rregullores.

(iii) AK nuk tregon cilat referenca i ka pranuar, sa është vlera e tyre dhe cilat produkte përmbajnë. As nuk e ka kontrolluar veçmas pragun prej 51% për liderin.

KËRKESË: Kërkojmë nga OSHP që ky pretendim të aprovohet si i bazuar, pasi lideri i GOE-së, MEKA SH.P.K., nuk ka dëshmuar furnizime me produkte të ngjashme me ato të Lotit 6 në vlerë prej së paku 3,315,000.00 €, siç kërkohet me pikën 9.1, Kërkesa 1 dhe pikën 9.2, Evidenca 1 të DT-së, nenin 69.2 të LPP-së dhe nenet 25.14 e 25.16 të Rregullores.

PRETENDIMI ANKIMOR 4: Mosverifikimi i çmimeve dhe Moszbatimi i procedures për çmimet jo-normalisht të ulëta

Sipas Listës së Çmimeve të dorëzuar nga Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë, rezulton se për disa artikuj janë ofruar çmime dukshëm të ulëta dhe jo proporcionale me kostot reale të produktit dhe çmimet që aplikohen në treg. Si artikulli nr 1 Bukë e bardhe, dhe art 2 Bukë e zezë me minimum 500 gr, si dhe për Artikullin nr. 5 – bukë e bardhë e ambalazhuar me folie najloni, me çmim 0.15 €, dhe bukë integrale për sanduiç, me çmim 0.16 €, çmimet e ofruara janë jashtëzakonisht të ulëta dhe ngrehin dyshim të arsyeshëm për mundësinë e realizimit të furnizimit me këto çmime te ofruara. Për këto produkte, përveç kostos së lëndëve të para dhe përbërësve të nevojshëm për prodhim, duhet të përfshihen edhe shpenzimet e prodhimit, paketimit/ambalazhimit, folie najloni, punës, energjisë, transportit, fuqis punetore dhe shpenzimeve të tjera që lidhen me furnizimin dhe dorëzimin e produktit deri ne destinacionin e caktuar (transportin) dhe për këtë arsye, çmimi i ofruar prej 0.15 € dhe 0.16 € konsiderohet si çmim spekulativ dhe i pa aritshem. AK gjate vlersimit te ofertave është dashur ta aplikon nenin 61 te LPP-se apo ta beje një verifikim të veçantë duke hulumtuar tregun ku ne kohen aktuale dhe në tregun aktual nuk kemi hasur produkte të njëjta me specifikat e kërkuara në Dosjen e Tenderit që ofrohen me çmim prej 0.15 dhe 0.16 cent e veçanërisht kur në këtë çmim duhet të përfshihet edhe ambalazhimi dhe furnizimi i produktit ne destinacionin e caktuar ku duhet perfshier edhe transporti ku i gjithe furnizimi eshte nga lenda e pare gruri i cili tregtohet në bursa dhe kjo e bën çmimin e ofruar objektivisht të dyshimtë në kosto reale dhe konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka qenë i obliguar të verifikojë nëse këto çmime janë jo normalisht të ulëta dhe se a janë realisht të zbatueshme dhe se operatori ekonomik mund ta realizojë furnizimin sipas specifikimeve teknike dhe kushteve të kontratës si ne rastin konkret kur kemi te bejme sikurse kjo procedur afategjate

prej 24 muaj kalendarik, se cili eshte fitimi i konpanis ne ofrim te ketyre shpenzimev etj, Për këtë arsye, kërkojmë që Autoriteti Kontraktues perveq mangesive qe i ka GOE i rekomandur, duke mos i permbushur kerkesat e percaktuara ne NJK dhe DT, perfshier edhe formimin e grupit ku sipas marveshjes konsiderohet qe kontrata eshte e pa zbatueshme, mungesen e kapitalit financiare, munges deshmije ne realizim e kontratave per buk dhe produkte te bukes te miret parasysh neni 1 dhe 7 i LPP-se duke trajtur edhe ofrimin e këtyre cmimeve te pa mundur ne realizim te kontrates, AK ta refuzon nje oferten financiarfe apo ku shprehimisht edhe ne Udhezuesin per prokurim publik kur ne nje procedur pranohen me me shumë se 03 oferta me çmimet e ndryshme dhe në çdo rast kur tenderët duken jo normalisht të ulët, Autoriteti Kontraktues do të veprojë në përputhje me nenin 61 të LPP-së dhe nenin 41 të Rregullores për Prokurimin Publik, si kushtin e pare e qe jane pranuar 03 oferta duke nxjer pragun mesatar te ofertave, kushtin nr 2. pragu 30% (mesatarja /1.3).

PLOTËSIM I PRETENDIMIT NR. 4 – ANALIZË E DETAJUAR EKONOMIKE: ÇMIME NËN KOSTON REALE TË PRODHIMIT (neni 61 dhe neni 59 të LPP-së; pika 11.1 e FDT-së lidhur me nenin 41 të Rregullores për Prokurimin Publik)

Në mbështetje dhe plotësim të Pretendimit nr. 4, parashtruesi i kërkesës paraqet analizën e mëposhtme ekonomike, të bazuar në kalkulimin e verifikuar të kostos së prodhimit (recepturës) dhe në krahasimin artikull për artikull të ofertave financiare për Lot 6, e cila dëshmon në mënyrë objektive dhe të matshme se çmimet e ofruara nga GOE i rekomanduar për artikujt me sasitë më të mëdha janë nën koston reale të prodhimit dhe, si të tilla, ekonomikisht të parealizueshme.

4.1. Krahasimi i çmimeve për njësi sipas artikujve të Lot 6

Nr.	Artikulli	Sasia (copë)	GOE i rekomanduar (€/copë, me TVSH)	Premium Bakery (€/copë, me TVSH)
1	Bukë e bardhë, min. 500 g	2,000,000	0.51	0.69
2	Bukë e zezë, min. 500 g	175,000	0.57	0.87
3	Kifle kroasan / kifle, min. 100 g	1,050,000	0.33	0.29
4	Byrek me mish/djathë/spinaq, 250 g	560,000	1.29	1.19
5	Bukë e bardhë e ambalazhuar me folie najloni, min. 100 g	3,000,000	0.15	0.26
6	Bukë integrale për sanduiç, min. 100 g	3,500,000	0.16	0.29
	TOTALI	**10,285,000**	**3,198,650.00 €**	**4,298,150.00 €**

Nga tabela e mësipërme konstatohet qartazi se: (i) te artikujt me kompleksitet real prodhimi (Art. 3 – kifle dhe Art. 4 – byrek), GOE i rekomanduar është MË I SHTRENJTË se parashtruesi i kërkesës (0.33 € kundrejt 0.29 € dhe 1.29 € kundrejt 1.19 €); dhe (ii) e tërë diferenca totale prej 1,099,500.00 € ndërmjet dy ofertave ndërtohet ekskluzivisht te artikujt me sasitë më të mëdha (Art. 1, 5 dhe 6 – gjithsej 8,500,000 copë), pikërisht aty ku çmimet e GOE-së bien nën ose në kufi të kostos së dokumentuar të prodhimit. Vetëm Art. 5 dhe Art. 6, të cilët përfaqësojnë 6,500,000 copë ose 63% të të gjitha njësive të kontratës, shpjegojnë 785,000.00 € ose 71.4% të kësaj diference. Ky është modeli tipik i çmimeve të pabalancuara dhe jo serioze, të cilat një ofertë e bëjnë "fituese" vetëm në letër, ndërsa në praktikë e bëjnë kontratën të paekzekutueshme.

Nivelin real të çmimeve të tregut e konfirmon edhe krahasimi ndërmjet dy prodhuesve të mëdhenj e të specializuar të bukës që kanë ofertuar në këtë Lot: oferta e parashtruesit të kërkesës

(4,298,150.00 €) dhe oferta e OE "KO-BAKE" (4,080,000.00 €) dallojnë ndërmjet tyre vetëm për 218,150.00 € ose rreth 5%. Kur dy furra industriale, të pavarura nga njëra-tjetra dhe me kosto reale prodhimi, konvergojnë brenda 5% të njëra-tjetrës, ky është treguesi më objektiv i çmimit real të tregut për këto produkte. Oferta e GOE-së së rekomanduar (3,198,650.00 €) devijon rreth 22%–26% nën të dyja këto oferta – devijim që nuk shpjegohet me asnjë avantazh real konkurrues (GOE nuk posedon as regjistrimin në AUV si prodhues buke për 90% të pjesëmarrjes së anëtarëve të vet), por vetëm me çmime jo serioze, nën kosto.

Çmimet e ofruara nga GOE i rekomanduar nuk janë në proporcion as me çmimet reale me të cilat produkte identike – bukë e ambalazhuar 100 g me folie, bukë 500 g apo bukë integrale – shiten sot në tregun e Republikës së Kosovës. Ky fakt është lehtësisht i verifikueshëm nga AK-ja me një hulumtim të thjeshtë tregu, si dhe përmes faturave, profaturave dhe çmimoreve të furnitorëve të lëndës së parë (miell, përmirësues, ambalazh), të cilat parashtruesi i bashkëngjit dhe/ose i vë në dispozicion me kërkesë.

4.2. Kosto e verifikuar e prodhimit për Artikullin nr. 5 (Bukë e bardhë min. 100 g, e ambalazhuar me folie najloni)

Si dëshmi materiale i bashkëngjitet këtij plotësimi kalkulimi i plotë i recepturës së prodhimit për produktin identik me Artikullin nr. 5 të Lot 6 (bukë e bardhë 100 g pas pjekjes, e ambalazhuar në qese najloni), i nxjerrë nga sistemi i kostimit të prodhimit të parashtruesit të kërkesës, me çmime reale e të verifikueshme të tregut për lëndën e parë dhe inputet e tjera (miell T-550: 0.367 €/kg, përmirësues brumi, maja, kripë, qese najloni, gaz LPG, energji elektrike, fuqi punëtore dhe shpenzime të përgjithshme):

Elementi i kostos (sipas recepturës së verifikuar të prodhimit)	**€ / copë**
Lënda e parë dhe ambalazhi (miell T-550, përmirësues, maja, kripë, qese najloni)	0.152
Kosto e prodhimit (gaz LPG, energji elektrike, fuqia punëtore, shpenzimet e përgjithshme)	0.028
Kosto e transportit deri te destinacioni i dorë zimit	0.030
KOSTO TOTALE PËR COPË (pa marzhë fitimi me TVSH)	**0.210**

Krahasimi i kësaj kostoje me çmimin e ofruar nga GOE i rekomanduar prej 0.15 €/copë me TVSH nxjerr këto konstatime të pakontestueshme:

a) çmimi i ofruar prej 0.15 € – madje edhe pa e zbritur fare TVSH-në – është nën koston e vetme të lëndës së parë dhe të ambalazhit prej 0.152 €/copë; pra ky çmim nuk e mbulon as materialin bazë të produktit, pa llogaritur fare shpenzimet e prodhimit, punës, energjisë dhe transportit;

b) pas zbritjes së TVSH-së, çmimi neto zbret në rreth 0.14 €/copë, që është rreth 33% nën koston totale minimale të prodhimit prej 0.210 €/copë (dhe çdo normë e aplikueshme e TVSH-së vetëm sa e thellon këtë diferencë);

c) mbi sasinë e kërkuar prej 3,000,000 copësh, realizimi i këtij artikulli me çmimin e ofruar do të gjeneronte humbje të drejtpërdrejtë minimale prej rreth 180,000.00 € deri në 213,000.00 € vetëm për Artikullin nr. 5;

d) për krahasim, çmimi i ofruar nga parashtruesi i kërkesës prej 0.26 €/copë me TVSH pasqyron pikërisht këtë kosto të verifikuar (0.210 €) plus një marzhë modeste dhe të arsyeshme afariste – pra përfaqëson çmimin real dhe të qëndrueshëm të tregut për këtë produkt.

4.3. Artikulli nr. 6 (Bukë integrale për sanduiç, min. 100 g)

E njëjta analizë vlen edhe për Artikullin nr. 6: edhe duke e përjashtuar tërësisht koston e ambalazhit (0.040 €/copë), kostoja minimale e prodhimit të një buke 100 g del rreth 0.170 €/copë, ndërkohë që mielli integral ka çmim më të lartë tregu se mielli i bardhë T-550, çka e rrit më tej këtë kosto. Çmimi i ofruar prej 0.16 €/copë me TVSH (rreth 0.15 € pa TVSH) është sërish nën kosto, duke gjeneruar humbje shtesë minimale prej rreth 77,000.00 € mbi sasinë prej 3,500,000 copësh.

4.4. Kalkulimi proporcional i kostos për artikujt e tjerë dhe humbja totale e pashmangshme

Normat e verifikuara të recepturës (1.164 € për kilogram brumi të përpunuar e të pjekur, plus 0.030 € transport për copë) mundësojnë llogaritjen proporcionale të kostos edhe për artikujt e tjerë, duke e skaluar koston me peshën e brumit të secilit produkt. Kjo llogaritje, e cila i bashkëngjitet kërkesës si dëshmi, tregon se nën kosto janë edhe dy artikujt e tjerë kryesorë: për Artikullin nr. 1 (bukë e bardhë min. 500 g, që kërkon rreth 0.600 kg brumë për copë), kostoja proporcionale rezulton rreth 0.73 €/copë – dhe mbetet rreth 0.59 €/copë edhe në skenarin më konservativ, me gjysmën e dozës së përmirësuesit – përballë çmimit të ofruar prej vetëm 0.51 €/copë me TVSH; për Artikullin nr. 2 (bukë e zezë min. 500 g, ku mielli i zi ka çmim tregu më të lartë se mielli i bardhë T-550), kostoja rezulton rreth 0.75 €/copë përballë çmimit të ofruar prej 0.57 €/copë.

Të përmbledhura: çmimet e ofruara nga GOE i rekomanduar për Artikujt 1, 2, 5 dhe 6 – të cilët përbëjnë 8,675,000 copë ose 84% të të gjitha njësive të kontratës – gjenerojnë një humbje të drejtpërdrejtë të pashmangshme prej rreth 700,000.00 € në terma bruto, gjegjësisht rreth 856,000.00 € në terma neto (pa TVSH), gjatë periudhës 24-mujore të kontratës. Në të kundërt, te Artikujt 3 dhe 4, ku çmimet e të dy ofertuesve janë normalisht mbi kosto, GOE i rekomanduar është MË I SHTRENJTË se parashtruesi i kërkesës – dëshmi shtesë se nënçmimi nuk është rezultat i ndonjë efikasiteti më të lartë, por është i përqendruar qëllimisht te artikujt me sasitë më të mëdha, për ta fituar tenderin me çmime që nuk mund të realizohen. Kësaj i shtohet edhe fakti se oferta është e një grupi prej TRE operatorësh ekonomikë: një çmim që nuk e mbulon as koston e prodhimit të një prodhuesi të vetëm nuk ka se si të gjenerojë fitim të ndashëm për tre operatorë, secili me strukturën e vet administrative, logjistike e financiare.

Përgjigjja e AK-së dhe pse është e gabuar

AK thotë se 0.51 € për bukën 500 g nuk është e ulët "ne raport me tregun (jo me ofertën e ankuesit)", se "(0.51/5=0.10€)", prandaj 0.15 € dhe 0.16 € për bukët 100 g nuk janë të ulëta, dhe se pa artikujt 5 e 6 GOE-ja përsëri është më e lirë.

(i) AK nuk ka asnjë të dhënë për tregun dhe nuk i ka kërkuar GOE-së asnjë sqarim. Ne nuk krahasojmë vetëm me ofertën tonë: edhe oferta e KO-BAKE e konfirmon nivelin e çmimeve.

(ii) Llogaria "0.51 ndarë me 5" nuk qëndron. Pesë bukë 100 g kanë nevojë për pesë qese dhe transport për pesë copë, ndërsa buka 500 g vetëm për një. Edhe me llogarinë e AK-së:

0.102 € + qesja 0.040 € + transporti 0.030 € = rreth 0.17 €. Edhe po ta zbresim pjesën e qeses dhe transportit që është tashmë brenda bukës 500 g (0.014 €), kostoja mbetet rreth 0.158 €, pra mbi 0.15 €. Për më tepër, AK e merr si të sigurt se 0.51 € e mbulon koston e bukës 500 g, gjë që ne e kontestojmë. Edhe ajo bukë duhet të jetë e prerë dhe në qese najloni. Buka integrale nuk mund të llogaritet njësoj, sepse mielli integral është më i shtrenjtë. Per me teper kostoja e fuqise puntore dhe pasijeve per prodhimin e 5 bukeve nga 100 gram eshte me e larte se prodhimi I nje buke prej 500 gram.

(iv) Totali nuk e zgjidh problemin. Neni 41.6 i Rregullores e lejon verifikimin për artikuj të veçantë. Pa artikujt 5 e 6, diferenca prej 314,500.00 € vjen vetëm nga artikujt 1 dhe 2, që janë gjithashtu nën kosto. Kur 63% e sasive ofrohen nën kosto, furnizimi për 24 muaj vihet në rrezik (neni 6 i LPP-së, neni 41.1 i Rregullores).

(v) Dhe ne fund ne gjate gjithe kohes percjellim edhe tregjet lobale te furnizimeve me lende te para siq jane mielli, gruri, paketimi dhe lendet djegese dhe siq kemi deshmuar edhe ne kohet kur ka patur rritje enorme te cmimve ne vitin 2020 kem furnizuar me qmime te dakorduara perkunder humbjeve te medha. Andaj jemi gjithmon te kujdshem ne krijimin e siguris se furnizimit e sidmos per institucionet qe jane jetike per vendin.

Në këtë kuptim, kalkulimi i kostos së prodhimit i paraqitur nga parashtruesi nuk kërkohet të merret si prova përfundimtare se çmimi është i pamundur, por si dëshmi objektive që demonstron ekzistencën e një dyshimi serioz dhe konkret për karakterin jo-normalisht të ulët të çmimeve. Pikërisht për këtë arsye AK ka qenë i detyruar të aktivizojë mekanizmin e verifikimit të paraparë në nenin 41.6 të Rregullores.

KËRKESË: Kërkojmë nga OSHP që ky pretendim të aprovohet si i bazuar dhe të konstatohet se AK ka qenë e obliguar t'i kërkojë GOE-së me shkrim sqarim dhe zbërthim të detajuar të çmimeve për artikujt 1, 2, 5 dhe 6, sipas nenit 61.1 të LPP-së dhe nenit 41.6 të Rregullores. Pas marrjes së sqarimit, AK të vlerësojë, sipas neneve 41.8 dhe 41.9 të Rregullores, nëse këto çmime janë ekonomikisht të realizueshme.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1	**Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare** **Kërkesa 1:** Operatori ekonomik duhet të ketë realizuar gjatë tre viteve të fundit nga publikimi i njoftimit për kontratë, **xhiro totale ne EURO** minimum: **Lot 1: 9,200,000.00€** **Lot 2: 4,870,000.00€** **Lot 3: 1,920,000.00€** **Lot 4: 6,900,000.00€** **Lot 5: 4,220,000.00€** **Lot 6: 8,700,000.00€** Në rast se operatori ekonomik dorëzon tender për te gjitha pjesët (lote), shuma totale e qarkullimit financiar qe kërkohet për tu shpërblyer me kontratë për të gjitha Pjesët-Lotet është totali i gjithave.

		Apo në rast se OE oferton vetëm për disa Pjesë-Lote per tu shpërblyer me kontratë duhet të plotësoj kërkesën duke pasur qarkullimin financiar në vlerën e atyre Pjesëve-Loteve së bashku (vlerat e paraqitura më lartë duhet të mblidhen për Pjesët që ofertoni). Ne rast te grupit të OE-ve, se paku 51% te plotësohet nga lideri i grupit. **Kërkesa 2:** Operatori ekonomik duhet të dëshmoj se ka kapital financiar për realizimin e kontratës, mjete të gatshme në bankë ose mbështetje bankare qasje te pakushtezuar në kredi për realizimin e kontratës ose bilanc pozitive tek Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit ne Pasqyra e rrjedhjes së parasë për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025- në vlerë prej së paku: **Lot 1 – 690,000.00€** **Lot 2 – 365,000.00€** **Lot 3 – 145,000.00€** **Lot 4 – 520,000.00€** **Lot 5 – 320,000.00€** **Lot 6 – 655,000.00€** Ne rast te grupit të OE-ve, se paku 51% te plotësohet nga lideri i grupit.
	8.2	**Dokumentet dëshmuese për gjendjen ekonomike dhe financiare** **Evidenca 1:** **Deklaratat Tatimore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës për tri vitet e shkuara ose Vërteteim te lëshuar dhe vërtetuar nga ATK-ja mbi qarkullimin financiar ne tri vitet e shkuara ose gjendje e përgjithshme të vlerësuar dhe vërtetuar nga ATK-ja .** Operatori ekonomik qe përmbush kërkesën e qarkullimit vetëm me një apo dy vite. Do të thotë se OE ka përmbushur kërkesën minimale te përcaktuar ne dokumentet e tenderit, kusht i domosdoshëm dhe i detyrueshëm për t'u kualifikuar. **Evidenca 2: Deklaratë nga banka që dëshmon se OE ka mjete të gatshme në xhirollogari ose qasje te pakushtezuar në kredi për realizimin e kontratës ose Pasqyra e rrjedhjes së parasë për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025 në vlerë prej minimumit te paraqitur tek kërkesa per secilin Lot qe oferton.** Nese dorëzohet dëshmi nga banka per mjete te gatshme dokumenti të jetë origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni Bankar. Në rastin e kredisë se pakushtezuar OE duhet të paraqes dokumentin nga banka në emër të aktivitetit te prokurimit – origjinal. Në rast se dorëzohen pasqyra e rrjedhës se parasë per vitin qe përfundon me 31.12.2025 duhet te jene te nënshkruara nga auditorët – rishikim i pasqyrave financiare.
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1	**Kërkesa 1:** Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses furnizim me produkte të ngjashme në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te këtij njoftimi për kontrate) minimum: **Lot 1: 6,900,000.00€**

		Lot 2: 3,650,000.00€ **Lot 3: 1,440,000.00€** **Lot 4: 5,170,000.00€** **Lot 5: 3,160,000.00€** **Lot 6: 6,500,000.00€** Në rast të grupit të OE-ve, së paku 51% e furnizimeve të përfunduara kërkohet për liderin e grupit. **Kërkesa 2:** Deklaratën për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara duke deklaruar që mallrat e ofruar nga ju janë sipas Aneksin 1 të dosjes së tenderit dhe Përshkrimit të artikullit tek Lista e Çmimeve. **Kërkesa 3:** Operatori i ekonomik duhet të jetë i regjistruar në regjistrin e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë si prodhues dhe përpunues i Bukës – **KËRKOHET VETËM per Lot 6.** **Kërkesa 4:** Operatori duhet të dëshmojë se posedon depo ftohëse - **KËRKOHET per Lot 1,2,3 dhe 4.** **Kërkesa 5:** Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka në dispozicion mjete transportuese me kapacitet të nevojshëm teknik – Frigo (ftohëse) për ruajtjen e zingjirit të ftohjes së produkteve, kërkohen nga se paku tri (3) pajisje per secilin Lot qe ofertoni. **KËRKOHET per Lot 1,2,3 dhe 4.**
	9.2	**Dokumentet dëshmuese për mundësitë teknike dhe/ose profesionale** **Evidenca 1:** Operatori Ekonomik duhet te plotësoj formularin standard të dhënë në Aneksin 8 te Dosjes se Tenderit dhe te bashkëngjis certifikatat përkatëse ose ndonjë dokument tjetër qe evidenton liferimin e tillë, ; (i) kur furnizimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e certifikatës (certifikata /raporti i përkohshëm i pranimit) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkë-nënshkruara nga autoriteti i tillë. të gjitha këto dëshmi duhet të kenë vlerën e realizuar. (ii) kur furnizimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i livrimit të tillë me dëshmi të pagesës nga banka; **Evidenca 2:** Deklaratën e nënshkruar për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara duke deklaruar që mallrat e ofruar nga ju janë sipas Aneksin 1 të dosjes së tenderit dhe Përshkrimit të artikullit tek Lista e Çmimeve. **Evidenca 3:** Dëshmi/Vendimi nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV)

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

DEKLARATË

Komisioni i vlerësimit të ofertave ka vlerësuar të gjitha ofertat e pranuara për këtë aktivitet të prokurimit dhe deklaron:

- **OE: Dauti Komerc SH.P.K**. është eliminuar për arsye nuk ka dorëzuar sigurim te tenderit, ka dorëzuar sigurime te ekzekutimit, pra pikat e sigurimit nuk janë te sigurimit te tenderit por te sigurimit te ekzekutimit dhe me këtë rast është vlerësuar si oferte e papërgjegjshme.
- **GOE: Delfin L.t.d. Sh.p.k.; Danlager Kosova L.L.C.** është eliminuar për arsye se nuk ka plotësuar në formën e duhur Listën e Çmimeve, vlera tek Lista e Çmimeve tek totali nuk është i njëjtë me vlerën e paraqitur tek Formulari i tenderit, nuk ka plotësuar Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare – Kërkesën 2 pasi që ka ofruar dëshmi vetëm për anëtarin e grupit dhe nuk ka ofruar asnjë dëshmi për Liderin andaj nuk e ka plotësuar kërkesën pasi qe është kërkuara "Ne rast te grupit të OE-ve, se paku 51% te plotësohet nga lideri i grupit." dhe me këtë rast është vlerësuar si oferte e papërgjegjshme.
- **OE: " Ko - Bake " Sh.p.k.** është eliminuar për arsye nuk ka dorëzuar sigurim te tenderit por ka dorëzuar vetëm faturën e sigurimit te tenderit, nuk ka plotësuar Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare pasi që nuk ka as qarkullim ne vlerën e kërkuar dhe as tek Cash flow (si dëshmi e vetme e ofruar) nuk ka vlerën e kërkuar tek Paraja dhe ekuivalentet e parasë në fund të vitit, nuk ka plotësuar Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pasi që nuk ka ofruar referenca në vlerën e kërkuar dhe me këtë rast është vlerësuar si oferte e papërgjegjshme.
- **GOE MEKA SH.P.K.; HC STORE SH.P.K.; Bajram R. Imeri B.I.** plotëson kërkesat - Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare dhe Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale vetëm për 2 Lote (jo për 3 lote që ka ofertuar) dhe me këtë rast duke pasur parasysh qe është oferta me çmimin me te ulet ne Lot 5 dhe Lot 6 atëherë rekomandohet për këto dy Lote dhe eliminohet për Lot 1 (ku edhe nuk është oferta me çmimin me te ulet).
- **Ofertat e tjera kane plotësuar te gjitha kërkesat e Njoftimit per Kontrate dhe Dosjes së Tenderit dhe bazuar ne kriterin e dhënies oferta e pergjegjeshme me çmimin me të ulët komisioni i vleresimit rekomandon per kontratë:**
- **Lot 1 - Apetiti SH.P.K në vlerën e paraqitur në ofertën e tij prej 3,944,600.00€.**
- **Lot 2 - Beni Dona Plast SH.P.K., në vlerën e paraqitur në ofertën e tij prej 1,599,440.00€.**
- **Lot 3 - Beni Dona Plast SH.P.K., në vlerën e paraqitur në ofertën e tij prej 887,650.00€.**
- **Lot 4 - Ananas -Impex SH.P.K., në vlerën e paraqitur në ofertën e tij prej 2,498,458.90€.**
- **Lot 5 - Grup i Operatorëve Ekonomik MEKA SH.P.K.; HC STORE SH.P.K.; Bajram R. Imeri B.I., në vlerën e paraqitur në ofertën e tyre prej 1,697,645.00€.**
- **Lot 6 - Grup i Operatorëve Ekonomik MEKA SH.P.K.; HC STORE SH.P.K.; Bajram R. Imeri B.I., në vlerën e paraqitur në ofertën e tyre prej 3,198,650.00€.**

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

Duke u bazuar në shkresat e lëndës, mendoj se operatori ekonomik ankues është palë interesi në ketë aktivitet të prokurimit

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **" Premium Bakery " SH.P.K.**

Eksperti shqyrtues ka analizuar në tërësi dhe me kujdes të gjitha pretendimet e paraqitura nga operatori ekonomik ankues në ankesën e tij. Për qëllime të qartësisë, koherencës dhe për të shmangur përsëritjet e panevojshme, pretendimet ankimore në këtë raport paraqiten në formë të përmbledhur, duke ruajtur thelbin e secilit pretendim ashtu siç është ngritur nga ankuesi. Pas secilit pretendim të përmbledhur, jepet përgjigjja përkatëse e ekspertit.

Pretendimi ankimor nr. 1 (i përmbledhur)

OE ankues pretendon se GOE i rekomanduar për kontratë nuk e përmbush **Kërkesën 3, pika 9.1 të Dosjes së Tenderit për Lotin 6**, sipas së cilës kërkohet që operatori të jetë i regjistruar në regjistrin e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë si prodhues dhe përpunues i bukës.

Sipas ankuesit, nga anëtarët e GOE-së vetëm **HOME BAKERY** posedon regjistrimin përkatës në AUV, ndërsa nga marrëveshja e grupit rezulton se pjesëmarrja e këtij anëtari në realizimin e kontratës është vetëm **10%**, krahasuar me **51% të MEKA SH.P.K.** dhe **39% të HC STORE SH.P.K.** Ankuesi thekson se marrëveshja e grupit nuk përcakton konkretisht se cili anëtar do të realizojë furnizimet për secilin lot, përkatësisht nuk përcakton se furnizimet e Lotit 6 do të kryhen nga HOME BAKERY.

OE ankues kundërshton arsyetimin e AK-së se kërkesa mund të plotësohet nga grupi si tërësi duke u mbështetur në kapacitetet e anëtarëve të tij. Sipas ankuesit, bazuar në **nenin 25.15 dhe nenin 26.8 të Rregullores për Prokurimin Publik**, autorizimin/licencën ose dëshminë përkatëse duhet ta posedojë anëtari i grupit që faktikisht do ta kryejë furnizimin. Po ashtu, duke iu referuar **nenit 69.8 të LPP-së**, ankuesi pretendon se GOE duhet të dëshmojë se do ti ketë në dispozicion burimet e nevojshme për ekzekutimin e kontratës.

Rrjedhimisht, ankuesi konsideron se, përderisa marrëveshja e GOE-së nuk përcakton që **HOME BAKERY**, si anëtari i vetëm që posedon dëshminë përkatëse të AUV-së, do të realizojë furnizimet e Lotit 6, nuk është dëshmuar përmbushja e Kërkesës 3 të DT-së dhe oferta e GOE-së nuk mund të konsiderohet e përgjegjshme.

Përgjigjja në pretendimin ankimor nr. 1

Eksperti shqyrtues, pas shqyrtimit të pretendimit ankimor, përgjigjes së AK-së, kërkesave të Dosjes së Tenderit dhe dokumentacionit të GOE-së së rekomanduar për kontratë, konstaton se në **Kërkesën 3 të pikës 9.1 të Dosjes së Tenderit**, vetëm për Lotin 6 është kërkuar që operatori ekonomik të jetë i regjistruar në regjistrin e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) si prodhues dhe përpunues i bukës, ndërsa si dëshmi është kërkuar Vendimi/Dëshmia përkatëse nga AUV.

Nga dokumentacioni i dorëzuar me ofertë nga GOE rezulton se këtë kërkesë specifike e plotëson anëtari **HOME BAKERY**, i cili posedon Vendimin e AUV-së për ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të bukës, simiteve dhe ëmbëlsirave të freskëta.

Në anën tjetër, nga **Deklarata për Themelimin e Grupit** rezulton se GOE ka ofertuar për

Lotet 1, 5 dhe 6, ndërsa pjesëmarrja në realizimin e kontratës është përcaktuar në masën **51% për MEKA SH.P.K., 39% për HC STORE SH.P.K. dhe 10% për HOME BAKERY**. Përgjegjësitë e anëtarëve janë përcaktuar sipas këtyre përqindjeve, mirëpo **nuk është bërë ndarja konkrete e detyrave dhe përgjegjësive sipas loteve apo produkteve**, përkatësisht nuk është përcaktuar se HOME BAKERY do të realizojë furnizimet e Lotit 6.

Eksperti shqyrtues ka parasysh referimin e AK-së në **nenin 71.4 të LPP-së**, sipas të cilit kërkesat përkatëse aplikohen ndaj grupit si tërësi. Megjithatë, në rastin konkret duhet marrë parasysh edhe **neni 25.15 i Rregullores për Prokurimin Publik**, sipas të cilit, kur kërkohet autorizim/licencë për përshtatshmërinë profesionale, atë duhet ta posedojë anëtari i grupit që kryen furnizimin përkatës.

Prandaj, çështja përcaktuese nuk është përqindja prej 10% e HOME BAKERY, por fakti se **nga dokumentacioni i dorëzuar me tender nuk mund të konstatohet se ky anëtar, mbi kapacitetin e të cilit GOE mbështetet për përmbushjen e Kërkesës 3, është njëkohësisht anëtari që do të realizojë furnizimet e Lotit 6**.

Nga **Deklarata për Themelimin e Grupit**, si dhe nga dokumentacioni tjetër i dorëzuar me ofertë, **nuk rezulton se HOME BAKERY është përcaktuar si anëtari që do të realizojë furnizimet e Lotit 6**. Një ndarje e tillë e detyrave sipas loteve apo produkteve nuk është deklaruar në ofertën fillestare; rrjedhimisht, nuk ekziston një informacion paraprak në ofertë nga i cili mund të konstatohet lidhja ndërmjet dëshmisë së AUV-së të HOME BAKERY dhe realizimit të furnizimeve të Lotit 6.

Bazuar në të lartcekurat, eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor është i bazuar, pasi vetëm fakti që anëtari HOME BAKERY posedon dëshminë e kërkuar nga AUV nuk është i mjaftueshëm për të konstatuar përmbushjen e Kërkesës 3, përderisa nga **Deklarata për Themelimin e Grupit dhe dokumentacioni i dorëzuar me ofertë nuk rezulton se pikërisht ky anëtar është përcaktuar për realizimin e furnizimeve të Lotit 6**, për të cilat është kërkuar dëshmia përkatëse e AUV-së.

Pretendimi ankimor nr. 2 (i përmbledhur)

OE ankues pretendon se GOE i rekomanduar për kontratë nuk e përmbush **Kërkesën 2, pika 8.1 të Dosjes së Tenderit**, me të cilën është kërkuar dëshmi për mjete të gatshme në bankë ose mbështetje bankare me **qasje të pakushtëzuar në kredi**, ku për Lotin 6 është përcaktuar shuma minimale prej **655,000.00 €**, ndërsa lideri i grupit duhet të përmbushë 51% të kësaj kërkese.

Sipas ankuesit, lideri **MEKA SH.P.K.** ka dorëzuar letrën e BKT-së, Prot. nr. **753/1519, datë 12.08.2026**, për Lotet 1, 5 dhe 6, në shumën deri në **1,665,000.00 €**. Megjithëse në këtë dokument banka shprehet se e mbështet shoqërinë "pa kushtëzim", ankuesi pretendon se vetë përmbajtja e letrës e kushtëzon financimin me fitimin e së drejtës për realizimin e projektit, si dhe me përmbushjen e kritereve të kreditimit, procedurave dhe rregulloreve të brendshme të bankës. Për këtë arsye, sipas ankuesit, dokumenti nuk dëshmon qasje të pakushtëzuar në kredi në kuptim të kërkesës së DT-së.

OE ankues kundërshton gjithashtu që kërkesa të konsiderohet e përmbushur përmes gjendjeve bankare të dorëzuara në ofertë, duke pretenduar se gjendja prej **421,234.46 €**, e datës 22.07.2026, nuk dëshmon disponueshmërinë e këtyre mjeteve deri në datën relevante të

tenderimit, ndërsa gjendja prej **68,776.15 €**, e datës 25.06.2026, i paraprin publikimit të tenderit.

Rrjedhimisht, ankuesi konsideron se dokumentacioni i dorëzuar nga lideri i GOE-së nuk dëshmon përmbushjen e kërkesës për mjete të gatshme apo **qasje të pakushtëzuar në kredi**, sipas **pikës 8.1, Kërkesa 2 dhe pikës 8.2, Evidenca 2 të DT-së**.

Përgjigjja në pretendimin ankimor nr. 2

Pas shqyrtimit të pretendimit ankimor, kërkesave të Dosjes së Tenderit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga GOE i rekomanduar për kontratë, eksperti shqyrtues konstaton se pretendimi ankimor **nuk qëndron**.

Për Lotin 6, Kërkesa 2 e DT-së ka përcaktuar kapacitet financiar në vlerë prej së paku **655,000.00 €**, ndërsa në rast të grupit të operatorëve ekonomikë është kërkuar që së paku **51% të plotësohet nga lideri i grupit**. Evidenca 2 ka paraparë mënyra alternative të dëshmimit të kësaj kërkese, përkatësisht përmes **mjeteve të gatshme në xhirollogari, qasjes së pakushtëzuar në kredi ose Pasqyrës së rrjedhjes së parasë për vitin që përfundon më 31.12.2025**.

Nga dokumentacioni i dorëzuar rezulton se lideri **MEKA SH.P.K.**, përveç letrës së BKT-së për mbështetje financiare, ka dorëzuar edhe dëshmi bankare për mjete të gatshme në xhirollogari. Në dokumentin e TEB-it të datës 22.07.2026 evidentohet gjendje prej **421,234.46 €**, e cila tejkalon shumën prej **334,050.00 €**, përkatësisht 51% të minimumit financiar të kërkuar për Lotin 6.

Gjithashtu, anëtari i grupit **HC STORE SH.P.K.** ka dorëzuar dëshmi bankare nga TEB-i me gjendje prej **428,370.04 €**, si dhe dokumentacion bankar nga Raiffeisen Bank. Dokumentacioni i anëtarit tjetër, HOME BAKERY, është po ashtu pjesë e dokumentacionit financiar të ofertës..

Rrjedhimisht, duke qenë se DT-ja ka lejuar **alternativisht** dëshmimin përmes mjeteve të gatshme në bankë dhe se dokumentacioni bankar i dorëzuar nga GOE dëshmon mjete që, të marra në kuadër të grupit, tejkalojnë minimumin prej **655,000.00 €**, ndërsa lideri MEKA SH.P.K. individualisht tejkalon minimumin prej 51%, eksperti shqyrtues vlerëson se **Kërkesa 2 për Lotin 6 është përmbushur**.

Për rrjedhojë, kontestimi i formulimit të letrës së BKT-së lidhur me "qasjen e pakushtëzuar në kredi" **nuk është përcaktues për rezultatin e vlerësimit**, pasi përmbushja e kërkesës dëshmohet përmes alternativës tjetër të paraparë shprehimisht në DT, përkatësisht **mjeteve të gatshme në xhirollogari**.

Bazuar në të lartcekurat, eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor nr. 2 është i pabazuar.

Pretendimi ankimor nr. 3 (i përmbledhur)

OE ankues pretendon se lideri i GOE-së, **MEKA SH.P.K.**, nuk e përmbush **Kërkesën 1, pika 9.1 të Dosjes së Tenderit**, sipas së cilës OE duhet të dëshmojë furnizime të përfunduara me sukses me **produkte të ngjashme** gjatë tri viteve të fundit, në vlerë minimale prej

6,500,000.00 € për Lotin 6, ndërsa në rast të grupit së paku **51% e kësaj vlere**, përkatësisht **3,315,000.00 €**, duhet të dëshmohet nga lideri i grupit.

Sipas ankuesit, nocioni "produkte të ngjashme" duhet të vlerësohet në raport me objektin konkret të Lotit 6, i cili përfshin kryesisht **bukë dhe produkte/brumëra të ngjashëm**, dhe jo si furnizim me çfarëdo produkti ushqimor. Në këtë drejtim, ankuesi i referohet nenit 69.2 të LPP-së dhe nenit 25.14 të Rregullores, duke pretenduar se përvoja e kërkuar duhet të jetë relevante me llojin dhe objektin e furnizimit.

OE ankues thekson se, ndonëse MEKA SH.P.K. ka paraqitur furnizime me vlerë të përgjithshme prej **12,929,610.00 €**, referencat e dorëzuara nuk dëshmojnë furnizime të ngjashme me produktet e Lotit 6. Konkretisht, referencat e **PROEX SH.P.K., ELKOS SH.P.K. dhe ELI-AB SH.P.K.** i referohen furnizimit me produkte të mishit, ndërsa referenca e **VIVA FRESH**, krahas produkteve të mishit, përmend në mënyrë të përgjithshme edhe "produkte të ndryshme ushqimore", pa specifikuar se cilat produkte janë furnizuar. Sipas ankuesit, nga këto dëshmi nuk mund të konstatohet se lideri ka realizuar furnizime me bukë apo produkte të tjera të ngjashme me ato të Lotit 6 në vlerën minimale të kërkuar.

Ankuesi pretendon gjithashtu se dokumentacioni përcjellës nuk mundëson identifikimin e produkteve konkrete të furnizuara dhe se as dokumentacioni i anëtarëve të tjerë të GOE-së nuk e plotëson këtë mungesë. Në veçanti, pretendohet se **HOME BAKERY**, ndonëse është anëtari që merret me produktet e bukës, nuk ka paraqitur dëshmi të mjaftueshme për furnizimet e deklaruara, ndërsa për **HC STORE SH.P.K.** kundërshtohet dokumentacioni i paraqitur për referencat dhe furnizimet e deklaruara.

OE ankues kundërshton përgjigjen e AK-së se GOE dhe lideri kanë dëshmuar furnizime në vlerë dukshëm më të lartë se minimumi i kërkuar, duke pretenduar se AK është përqendruar vetëm në **vlerën totale të furnizimeve**, pa verifikuar nëse ato kanë të bëjnë me **produkte të ngjashme me Lotin 6**, si dhe pa evidentuar konkretisht se cilat referenca dhe vlera janë pranuar për përmbushjen e pragut prej 51% nga lideri.

Rrjedhimisht, ankuesi konsideron se **MEKA SH.P.K. nuk ka dëshmuar furnizime me produkte të ngjashme me ato të Lotit 6 në vlerë prej së paku 3,315,000.00 €**, sipas kërkesave të përcaktuara në DT dhe dispozitave ligjore e nënligjore të referuara në ankesë.

Përgjigjja në pretendimin ankimor nr.3

Pas shqyrtimit të pretendimit ankimor, kërkesave të Dosjes së Tenderit dhe dokumentacionit të dorëzuar me tender, eksperti shqyrtues konstaton se për **Lotin 6 – "Furnizim me bukë dhe brumëra të tjera"**, është kërkuar që operatori ekonomik të dëshmojë furnizime të përfunduara me sukses me **produkte të ngjashme**, në vlerë minimale prej **6,500,000.00 €**, gjatë tri viteve të fundit duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë. Në rast të grupit të OE-ve, DT-ja ka përcaktuar që së paku **51% e furnizimeve të kërkuara**, përkatësisht **3,315,000.00 €**, të dëshmohet nga lideri i grupit.

Meqenëse Njoftimi për Kontratë është publikuar më **25.06.2026**, për qëllim të këtij kriteri relevante janë furnizimet e realizuara brenda periudhës së përcaktuar me DT, ndërsa vlerat e realizuara jashtë kësaj periudhe nuk mund të llogariten në përmbushjen e kërkesës.

Sa i përket kuptimit të termit **"produkte të ngjashme"**, eksperti shqyrtues vlerëson se

ngjashmëria duhet të shqyrtohet në raport me **objektin konkret të Lotit 6**, dhe jo vetëm me titullin e përgjithshëm të aktivitetit "Furnizim me artikuj ushqimor". Kjo për faktin se kërkesa për përvojën është përcaktuar veçmas dhe me vlerë të veçantë për këtë lot; rrjedhimisht, furnizimet e dëshmuara duhet të kenë lidhje të identifikueshme me natyrën e produkteve që janë objekt i Lotit 6, përkatësisht **bukë dhe brumëra të tjera**.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të liderit **MEKA SH.P.K.**, rezultojnë referenca me vlera të konsiderueshme, mirëpo një pjesë e tyre identifikojnë shprehimisht furnizime me **produkte të mishit**, ndërsa referencat e tjera përdorin përshkrime të përgjithshme, si **"produkte ushqimore", "produkte të ndryshme ushqimore"** apo formulime të ngjashme. Nga këto të fundit nuk mund të përcaktohet se cilat produkte konkrete janë furnizuar dhe, rrjedhimisht, as çfarë vlere mund tu atribuohet furnizimeve të ngjashme me objektin e Lotit 6. Vetëm fakti se furnizimet bëjnë pjesë në kategorinë e gjerë të produkteve ushqimore nuk është i mjaftueshëm për të konstatuar përmbushjen e kërkesës specifike për **produkte të ngjashme**.

Në anën tjetër, dokumentacioni i anëtarit **HOME BAKERY** identifikon shprehimisht furnizime me **"bukë dhe brumëra të tjera"**, të cilat për nga natyra lidhen drejtpërdrejt me objektin e Lotit 6. Megjithatë, përveç çështjes së periudhës së disa furnizimeve të deklaruara, vlera e tyre nuk është e mjaftueshme për përmbushjen e kriterit dhe, në çdo rast, nuk mund të zëvendësojë kërkesën e shprehur të DT-së që së paku **51% e furnizimeve të kërkuara të dëshmohet nga lideri i grupit**.

Për rrjedhojë, nga dokumentacioni i dorëzuar me tender **nuk mund të konstatohet se lideri MEKA SH.P.K. ka dëshmuar së paku 3,315,000.00 € furnizime me produkte të ngjashme me objektin e Lotit 6**, siç kërkohet në DT. Në veçanti, për referencat me përshkrime të përgjithshme nuk është e mundur të identifikohet nga dokumentacioni aktual natyra konkrete dhe vlera e furnizimeve që mund të konsiderohen të ngjashme me Lotin 6.

Megjithatë, duke qenë se në dokumentacionin e liderit ekzistojnë referenca për furnizime të realizuara, një pjesë e të cilave përshkruhen në mënyrë të përgjithshme si **"produkte ushqimore"** apo **"produkte të ndryshme ushqimore"**, eksperti shqyrtues vlerëson se gjatë rivlerësimit AK-ja duhet të sqarojë/verifikojë përmbajtjen e këtyre referencave, me qëllim të përcaktimit nëse brenda tyre janë realizuar furnizime me produkte të ngjashme me objektin e Lotit 6 dhe, nëse po, në çfarë vlere.

Çdo sqarim apo dokument shtesë duhet të kufizohet në dëshmimin e një gjendjeje që ka ekzistuar para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve dhe nuk mund të përdoret për krijimin e një kapaciteti apo përvoje të re pas këtij afati, apo për ndryshimin material të tenderit.

Bazuar në të lartcekurat, eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor është i bazuar.

Pretendimi ankimor nr. 4 (i përmbledhur)
OE ankues pretendon se Autoriteti Kontraktues, gjatë vlerësimit të ofertës së GOE-së së rekomanduar, nuk ka verifikuar çmimet e disa artikujve të Lotit 6 dhe nuk ka zbatuar procedurën për çmimet jo-normalisht të ulëta, sipas nenit 61 të LPP-së dhe nenit 41 të Rregullores për Prokurimin Publik.

Sipas ankuesit, dyshimi lidhet veçanërisht me artikujt **1, 2, 5 dhe 6**, përkatësisht bukën e

bardhë dhe të zezë minimum 500 g, bukën e bardhë të ambalazhuar minimum 100 g dhe bukën integrale për sanduiç minimum 100 g. Për artikujt 5 dhe 6 janë ofertuar çmime prej **0.15 €/copë** dhe **0.16 €/copë**, të cilat, sipas ankuesit, nuk janë proporcionale me kostot reale të prodhimit dhe furnizimit.

Në mbështetje të pretendimit, ankuesi ka paraqitur analizë të kostos së prodhimit, duke përfshirë lëndën e parë, ambalazhimin, energjinë, fuqinë punëtore, transportin dhe shpenzimet e tjera. Për artikullin nr. 5 pretendohet një kosto minimale prej rreth **0.210 €/copë**, kundrejt çmimit të ofertuar prej **0.15 €/copë**. Ankuesi mbështetet gjithashtu në krahasimin me ofertat e operatorëve të tjerë dhe në sasitë e konsiderueshme të furnizimit gjatë kontratës **24-mujore**.

OE ankues konsideron se AK është përqendruar në krahasimin e çmimeve ndërmjet ofertave, pa verifikuar realizueshmërinë ekonomike të çmimeve të GOE-së së rekomanduar. Sipas tij, rrethanat e paraqitura kanë krijuar dyshim të arsyeshëm që obligonte AK-në të kërkonte nga GOE **sqarim dhe zbërthim të detajuar të çmimeve** dhe, pas marrjes së tyre, të vlerësonte nëse çmimet janë ekonomikisht të realizueshme.

Rrjedhimisht, ankuesi kërkon të konstatohet se AK është dashur të aktivizojë mekanizmin e verifikimit të çmimeve të kontestuara para përfundimit të vlerësimit të ofertës.

Përgjigjja në pretendimin ankimor nr. 4

Pas shqyrtimit të pretendimit ankimor, analizës së kostos të paraqitur nga OE ankues dhe krahasimit të ofertave financiare të dorëzuara për **Lotin 6 – "Furnizim me bukë dhe brumëra të tjera"**, eksperti shqyrtues konstaton se pretendimi i ankuesit lidhet me çmimet e ofertuar nga GOE i rekomanduar për pozicione të caktuara, për të cilat pretendohet se janë nën koston reale të prodhimit dhe, rrjedhimisht, është dashur të trajtohen sipas dispozitave për çmimet jo-normalisht të ulëta.

Eksperti shqyrtues ka marrë në konsideratë analizën e kostos të paraqitur nga OE ankues, e cila përmban kalkulime lidhur me elementet e prodhimit të artikujve të kontestuar. Kjo analizë paraqet element relevant për shqyrtimin e pretendimit; megjithatë, ajo nuk dëshmon në vetvete strukturën reale të kostos së GOE-së së rekomanduar dhe as se çmimet e ofertuar prej tij janë ekonomikisht të parealizueshme.

Nga krahasimi i ofertave financiare rezulton se GOE i rekomanduar ka ofertuar për gjashtë pozicionet çmimet **0.51 €, 0.57 €, 0.33 €, 1.29 €, 0.15 € dhe 0.16 €**. . Ndërsa OE ankues ka ofertuar për të njëjtat pozicione **0.69 €, 0.87 €, 0.29 €, 1.19 €, 0.26 € dhe 0.29 €**. , Nga ky krahasim rezulton se diferencat nuk paraqiten në mënyrë të njëtrajtshme në të gjitha pozicionet; GOE i rekomanduar ka çmime më të ulëta në disa pozicione, ndërsa në pozicionet nr. 3 dhe 4 çmimet e OE ankues janë më të ulëta.

Rrjedhimisht, vetëm ekzistenca e diferencave ndërmjet çmimeve të ofertuesve, edhe kur ato janë më të theksuara në pozicione të caktuara, nuk është e mjaftueshme që çmimet e GOE-së së rekomanduar të cilësohen automatikisht si jo-normalisht të ulëta. Po ashtu, nga provat e paraqitura në kuadër të këtij pretendimi nuk është dëshmuar se çmimet e kontestuara janë të parealizueshme apo se ekzistojnë rrethana të mjaftueshme që do të impononin trajtimin e tyre sipas procedurës për çmime jo-normalisht të ulëta.

Për këto arsye, eksperti shqyrtues vlerëson se nuk është dëshmuar se AK-ja ka qenë e

obliguar që ofertën apo pozicionet e kontestuara të GOE-së së rekomanduar ti trajtojë si çmime jo-normalisht të ulëta sipas nenit 41 të Rregullores për Prokurimin Publik. Prandaj, pretendimi ankimor vlerësohet i pabazuar.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **Agjencia Qendrore e Prokruimit**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **" Premium Bakery " SH.P.K.**

Ibadete Guri